

## **Mirë se vjen në Entin Shtetëror për Konkurrencë – institucionin për konkurrencë dhe shitje!**

### **Çka është konkurrenca?**

Konkurrenca është kur shumë ndërmarrje shesin lloj të njëjtë të mallit. Ndërmarrjet gjithashtu bëjnë gara për blerësit. Ato konkurojnë për blerësit duke i zbritur çmimet dhe duke bërë mallra më të mira.

Për këtë arsye konkurrenca është e mirë për konsumatorët.

Kur konkurrenca funksionon, ndërmarrjet medoemos duhet të jenë gjithnjë e më të mira që të mund t'i shesin mallrat e tyre. Por, medoemos duhet të gjenden rregullat për atë se si do të funksionojë konkurrenca. Për këtë arsye ekziston një ligj që quhet Ligji për konkurrencën.

### **Pse janë të ndaluara kartelet?**

Ligji për konkurrencën thotë se ndalohe formimi i karteleve. Një kartel është kur më shumë ndërmarrje që shesin mallin e njëjtë bashkëpunojnë për çmimin e mallit. Ato fshehurazi vendosin që ndërmarrjet ta kenë çmimin e njëjtë për mallin e vet. Atëherë konkurrenca pushon të funksionojë, gjë që gjithashtu është e ndaluar.

Edhe Bashkimi Evropian, BE/EU, ka rregulla për konkurrencën. Ato rregulla po ashtu vlejné edhe në Suedi.

### **Çka është blerja?**

Enti Shtetëror për Konkurrencë do të përkujdeset që institucionet suedeze ta respektojnë ligjin për blerje publike. Secilën herë kur institucioni shtetëror do ta blejë një mall ose një shërbim, institucioni shtetëror do të bëjë blerje publike. Kjo do të thotë se institucioni shtetëror që më parë medoemos duhet të deklarohet se çka ai dëshiron të blejë. Kështu më shumë ndërmarrje kanë mundësi që t'i përshkruajnë mallrat dhe shërbimet e veta para se institucioni shtetëror të vendosë se prej cilës ndërmarrje do të blejë.

### **Çka është Enti Shtetëror i Konkurrencës?**

Enti Shtetëror i Konkurrencës është një institucion shtetëror. Ne do të përkujdesemi që ndërmarrjet t'i respektojnë rregullat për konkurrencën dhe që institucionet shtetërore ta respektojnë ligjin për blerje publike. Ne do të paraqesim propozime të rregullave të reja, të cilat konkurrencën mund ta bëjnë edhe më të mirë. Ne mbështesim ata që bëjnë hulumtime për konkurrencën dhe blerjen.

Enti Shtetëror i Konkurencës udhëhiqet nga drejtori gjeneral.

**Ti mund të kontaktoshë me ne kështu**

Dëshiron të dish më shumë, dërgo e-post në [konkurrensverket@kkv.se](mailto:konkurrensverket@kkv.se)

Mund të dërgoshë faks në numrin e faksin 08-24 55 43

ose telefono në numrin e telefonit 08-700 16 00